REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Date 13/02/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.2 Date 13.02.2026,"NJE SHTESE NE BUXHETIN E BASHKISE HAS PER VITIN 2026 (AKT TRASHEGIMIA 2025 NE BUXHETIN 2026)

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", paraqitet për miratim shtesa e fondeve në buxhetin e vitit 2026, si rezultat i fondeve të trashëguara nga viti buxhetor 2025.

Pas rakordimit me Degën e Thesarit Has, rezulton se Bashkia Has ka trashëguar fonde në vlerën totale **24,350,348 lekë**, të ndara si më poshtë:

- 17,350,992.13 lekë – Transferta e pakushtëzuar (trashëguar nga 2025)
- 6,999,356 lekë – Të ardhura të veta të trashëguara nga viti 2025

Këto fonde parashikohet të shpërndahen në shpenzime për:

- Likuidimin e detyrimeve të prapambetura (kolaudime, supervizime, punime investimesh)
- Vijimin e projekteve investuese në proces
- Shpenzime kapitale për infrastrukturë rrugore dhe arsimore
- Transferte kapitali
- Shpenzime sociale
- Pagesa paga dhe sigurime shoqërore nga të ardhurat e veta

Ky rishpërndarje siguron:

- Vijimësinë e projekteve investuese pa krijuar detyrime të reja të prapambetura
- Likuidimin e angazhimeve kontraktore ekzistuese
- Stabilitet financiar dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor buxhetor

Miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm për reflektimin në sistemin AFMIS dhe për vijimin normal të ekzekutimit të buxhetit 2026.

Për sa më sipër, fondet janë alokuar në mënyrë të tillë që të likuidohen të gjitha proçedurat e mbartura nga viti 2025 (si rezlutat të ulet risku i shtimit të detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Has për vitin 2025) dhe gjithashtu diferenca e mbetur është alokuar në investime dhe shpenzime me rëndësi strategjike për Bashkine Has.

Faleminderit per bashkepunimin.

Konceptoi:

Grislanda Bajraktari

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al.